

---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**FONDACIONI LOGOS**  
**KOLEGJI UNIVERSITAR “LOGOS”**

---



---

**PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT**  
**2025 - 2030**

---

**Hartuar nga Rektorati me dt.\_\_\_\_**

**Miraturar me Vendimin nr.\_\_\_\_, dt. \_\_ të Senatit Akademik**

**Miraturar me Vendimin nr.\_\_\_\_, dt. \_\_ te Bordit Drejtues të Fondacionit “LOGOS”**

## **Përmbajtja**

|                                                                            |           |
|----------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>HYRJE .....</b>                                                         | <b>4</b>  |
| <b>1. ARRITJET DHE SFIDAT KRYESORE 2018 – 2024.....</b>                    | <b>5</b>  |
| 1.1 Struktura Akademike e Njësive .....                                    | 7         |
| 1.2 Programet e studimit të Kolegjit Universitar “LOGOS” .....             | 7         |
| 1.3 Personeli akademik në Kolegjin Universitar “LOGOS” .....               | 13        |
| 1.4 Kërkimi shkencor dhe Sigurimi cilësisë .....                           | 15        |
| 1.4.1 Kërkimi Shkencor .....                                               | 15        |
| 1.4.2 Botime shkencore.....                                                | 15        |
| 1.5 Sigurimi Cilësisë .....                                                | 16        |
| 1.6 Infrastruktura didaktike dhe Biblioteka .....                          | 17        |
| 1.6.1 Laboratorët në dispozicion .....                                     | 17        |
| 1.6.2 Bibloteka .....                                                      | 18        |
| <b>2. Pikat e forta dhe të dobta pas Analizës së Situatës Aktuale.....</b> | <b>19</b> |
| 2.1 Pikat e Forta.....                                                     | 19        |
| 2.2 Pikat e Dobëta .....                                                   | 20        |
| 2.3 Kërcënime.....                                                         | 20        |
| 2.4 Oportunitete .....                                                     | 21        |
| <b>3. OBJEKTIVAT DHE STRATEGJITË 2025-2030.....</b>                        | <b>21</b> |
| 3.1 Vizioni, misioni, vlerat thelbësore .....                              | 21        |
| 3.2 Përcaktimi i Objektivave Strategjike.....                              | 22        |
| 3.2.1 Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit.....                               | 22        |
| 3.2.2 Stabiliteti dhe rritja e qëndrueshme e regjistrimeve .....           | 23        |
| 3.2.3 Përshtatshmëria me Vizionin dhe Misionin .....                       | 23        |
| 3.2.4 Rritja e Ndërkombëtarizimit.....                                     | 23        |
| 3.2.5 Kërkimi dhe inovacioni.....                                          | 23        |
| <b>4. STRATEGJITË KRYESORE .....</b>                                       | <b>24</b> |
| 4.1 Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit.....                                 | 24        |
| 4.1.1 Përditësimi i Kurrikulave: .....                                     | 25        |
| 4.1.2 Integrimi i Teknologjisë në Mësimdhënie: .....                       | 25        |
| 4.1.3 Metodot Inovative të Mësimdhënies: .....                             | 25        |
| 4.1.4 Vlerësimi i Performancës Akademike:.....                             | 26        |
| 4.1.5 Trajnimi i Stafit Akademik.....                                      | 26        |
| 4.2 Përmirësimi i Infrastrukturës së Mësimi:.....                          | 27        |
| 4.3 Monitorimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë.....                  | 27        |
| 4.4 Të vijohet me Analizën e tregut për çdo program studimi .....          | 28        |
| 4.4.1 Analizë e tregut për çdo program studimi .....                       | 28        |
| 4.4.2 Segmentimi i Studentëve.....                                         | 28        |

|                                                                                                                              |           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>4.5 Identifikimi i Nevojave dhe Preferencave të Segmenteve .....</b>                                                      | <b>28</b> |
| <b>4.6 Monitorimi i konkurrencës dhe mundësive në treg.....</b>                                                              | <b>29</b> |
| <b>5. PLAN VEPRIMET .....</b>                                                                                                | <b>29</b> |
| <b>5.1 Plan veprimi për rritjen e ndërkombëtarizimit .....</b>                                                               | <b>29</b> |
| 5.1.1 Objektivi: Rritja e kapaciteteve për ndërkombëtarizim.....                                                             | 29        |
| 5.1.2 Objektivi: Programe studimi të përbashkëta dhe mobilitete afatgjata, me fokus kryesor ciklin e dytë dhe të tretë. .... | 30        |
| 5.1.3 Objektivi: Kërkim i përbashkët shkencor sipas standardeve ndërkombëtare.....                                           | 30        |
| 5.1.4 Objektivi: Ndërkombëtarizimi përmes mësimdhënies .....                                                                 | 31        |
| 5.1.5 Objektivi: Krijimi i bashkëpunimeve të qëndrueshme me partnerë të huaj .....                                           | 31        |
| 5.1.6 Objektivi: Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare.....                                                    | 31        |
| <b>5.2 Plan veprimi për bashkëpunimin me Partnerë.....</b>                                                                   | <b>32</b> |
| Krijimi i Partneriteteve me Industrinë Lokale.....                                                                           | 32        |
| 5.2.1 Programet e Praktikës dhe Trajnimit:.....                                                                              | 32        |
| 5.2.2 Projekte të Përbashkëta Kërkimore: .....                                                                               | 32        |
| 5.2.3 Evente dhe Workshop-e të Përbashkëta: .....                                                                            | 33        |
| 5.2.4 Këshillat dhe Komitetet Këshillimore.....                                                                              | 33        |
| <b>5.3 Plan veprimi për rritjen e qëndrueshme dhe cilësore të regjistrimeve në Kolegjin Universitar “LOGOS” .....</b>        | <b>33</b> |
| 5.3.1 Fushata Marketingu dhe Promovimi: .....                                                                                | 34        |
| 5.3.2 Zgjerimi i Ofertës Akademike:.....                                                                                     | 34        |
| 5.3.3 Bursa dhe Ndihma Financiare: .....                                                                                     | 34        |
| 5.3.4. Metodat e Reja për Promovimin e Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe Tërheqjen e Aplikantëve Cilësorë: .....              | 35        |
| 5.3.5 Shërbime dhe Mbështetje për studentët në kuadër të Ndërkombëtarizimit:.....                                            | 35        |
| 5.3.6. Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Ambientit të Studimeve:.....                                                        | 35        |
| 5.3.7. Lidhja me Biznesin dhe Mundësitë e Karrierës: .....                                                                   | 35        |
| 5.3.8. Angazhimi dhe Aktivitetet Studentore: .....                                                                           | 36        |
| 5.3.9. Marrëdhëniet me Komunitetin dhe Institucionet e Tjera Arsimore: .....                                                 | 36        |

# HYRJE

## Data e themelimit

Kolegji Universitar “LOGOS” është institucion privat, jofitimprurës, i themeluar në vitin 2008, dhe me seli në Tiranë, Shqipëri. Veprimtaria e tij është pjesë e Fondacionit « LOGOS », i regjistruar si person juridik me Vendim Nr. 284, datë. 26.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kolegji u licencua për ushtrimin e veprimtarisë arsimore me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1055, datë 29.07.2009 “Për licencimin e Shkollës së Lartë Private “Logos” (SHLP “LOGOS”), sot Kolegji Universitar “LOGOS”.

## Themeluesi

Kolegji Universitar “LOGOS” u themelua nga Kryepeshkopi i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Prof. Dr. Anastasios Yannoulatos dhe njëkohësisht Presidenti i Fondacionit “Logos”. Kryepeshkopi Anastasios Yannoulatos është erudit i njohur, i cili ka shërbyer si Profesor i Historisë së Shkencave Fetare në Universitetin Shtetëror të Athinës, Kapodistria nga viti 1972 - 1992 dhe sot mban titullin Profesor Nderi në këtë universitet dhe është Anëtar Nderi në Akademinë e Athinës. Ai është Senator Nderi në Akademinë Evropiane të Shkencës dhe Artit në Salsburg që prej vitit 2019. Ai ka marrë titullin Doktor Nderi në Teologji dhe Filozofi nga njëzetë universitete, shkolla universitare dhe departamente (nga Greqia, Amerika, Qiproja, Rumania, Gjeorgjia, Shqipëria dhe Italia).

## Iniciativa Arsimore

Kolegji Universitar “LOGOS” mbart ndihmesën e rëndësishme të themeluesit të tij dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë për të rinjtë dhe më gjerë akoma për shoqërinë shqiptare përmes arsimit në të gjitha nivelet.

Që prej vitit 2008, duke ndjekur ecurinë e sistemit arsimor në Shqipëri, u krijua Fondacioni “LOGOS”, i cili u mbështet në përvojën dhe suksesin e Institutit të Formimit Profesional “Frymë Dashurie” nga dolën dy fakultetet e atëhershme që qenë edhe pjesë e Kolegjit Universitar “Logos”, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Fakulteti Ekonomik. Në vitin 2018 u shtua edhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.

## Emri dhe motoja

Emri “LOGOS” dhe motoja shoqëruese e tij *“dritë dhe fuqi jete”* përmbledh me pak fjalë kuptimin dhe qëllimin e krijimit dinamik akademik me këndvështrim të hapur: pasurimi i mendimit njerëzor, studim kërkimor, zgjerim i dijes, trajnim i të rinjve të kualifikuar që do të punojnë dhe ndihmojnë në zhvillimin shumëdimensional të shoqërisë moderne. Të porsadiplomuarit do të gëzojnë avantazhe nga dhurata e dijes (logos) në mënyrë krijuese, në shprehjen e frymëzimit, dhe në fuqinë e brendshme të Fjalës (Logos), e cila sjell dritë dhe fuqi për jetën.

Kolegji Universitar “LOGOS” është përkushtuar të pajisë studentët me këndvështrimin individual dhe profesional, me veprimtari jashtëmësimore, praktika pune, mobilitete dhe ndërmjetësim karriere, si dhe mbështetur në vizionin e Fondacionit dhe vendimet e Senatit dhe Bordit të Administrimit.

Sipas vendimeve të Senatit dhe Bordit të Administrimit, Kolegji Universitar “LOGOS” është i dedikuar të përgatisë studentët për të ardhmen profesionale dhe personale, duke ofruar programe bashkëkohore, përvojë ndërkombëtare, veprimtari ekstrakurrikulare, internship, mobilitete ndërkombëtare dhe mentorim në karrierë.

## **1. ARRITJET DHE SFIDAT KRYESORE 2018 – 2024**

Aktiviteti i Kolegjit Universitar “LOGOS”, gjatë viteve akademike 2018 deri në vitin 2024 është realizuar në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit për këtë periudhë dhe ka shënuar këto arritje kryesore:

### *1. Në aspektin e zhvillimit institucional*

- Kolegji Universitar “LOGOS” ka investuar në zhvillimin e strukturave të duhura të qeverisjes dhe kapacitetin e menaxhimit për të mbështetur një qëndrueshmërinë e institucionit, të stafit dhe studentëve të tij.
- Në vëmendje për zhvillimin institucional ka qenë aftësimi i studentëve për punë e sipërmarrje duke ju mundësuar studentëve aplikimin e njohurive teoriko-shkencore të marra përmes laboratorëve në ambientet e Kolegjit Universitar “LOGOS”, përmes krijimit të qendrës për sipërmarrësit e rinj, qendrës së mësimi të vazhdueshëm, etj., të mbështetura edhe përmes projekteve të financuara nga BE, si edhe nëpërmjet praktikave pranë subjekteve partnere të Kolegjit Universitar “LOGOS” apo Fondacionit LOGOS.
- Janë përmbyllur me sukses disa akreditime programesh studimi, dhe janë marrë nga bordi i akreditimit të ASCAL vendimet respektive të akreditimit që rezultojnë me afate drejt maksimales dhe dukshëm me rritjen të konsiderueshme krahasuar me periudhën e 2013-2018.
- Ka rritje të konsolidimit të imazhit të institucionit nëpërmjet website të Kolegjit Universitar “LOGOS”, rrjeteve sociale të tij, radios “Ngjallja”, mediave të tjera, aktiviteteve publike të zhvilluara në Kolegjit Universitar “LOGOS”, kontakteve të drejtpërdrejta me shkollat e mesme, zgjerimit të partneritetit me institucione dhe organizata të ndryshme, zgjerimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, mediatik, etj.
- Janë realizuar studime dhe analiza për hapjen e programeve të reja të studimit pranë Kolegjit Universitar “LOGOS”.

### *2. Në aspektin e zhvillimeve akademike*

- U zbatua qasja “studenti në qendër” të mësimdhënies dhe të gjithë veprimtarisë së institucionit.

- Kolegji Universitar “LOGOS” përgjatë këtyre viteve akademike ka sjellë risi në tregun e arsimit të lartë në Shqipëri përmes aplikimit për programe studimi ndërdisiplinore në MAS (disa janë miratuar dhe disa janë në proces). Kolegji Universitar “LOGOS” gjatë gjithë veprimtarisë së tij ka synuar të ofroj programe studimi në përputhje me tendencat e ndërkombëtare por duke ruajtur dhe konsoliduar më shumë në edukimin e brezave të cilët do mund të kontribuojnë në prosperitetin e Shqipërisë.
- U përmirësua cilësia e personelit akademik me rekrutimin e pedagogëve të brendshëm dhe të jashtëm me tituj e grada, me përvoja akademike dhe ekspertizë në fushë dhe personalitete të spikatura.
- Janë zhvilluar leksione të hapura dhe trajnime me personelin akademik duke u mbështetur edhe përmes projekteve ku Kolegji Universitar “LOGOS” ka qenë partner apo drejtues projekti.
- Kolegji Universitar “LOGOS” ka mbështetur nevojat për aplikimin e teknologjisë mësimore në shërbim të studentëve dhe pedagogëve, në përgjigje të kushteve të reja të të nxëniet nga studentët pas eksperiencave të mësimin në distance të diktuar nga COVID 19 duke aplikuar me sukses në vijimësi përdorimin e platformës TEAMS për përcjelljen e materialeve mësimore dhe komunikimin në klasa virtuale sipas çdo lënde nga pedagogët dhe studentët si dhe të platformës EDUpage.

### *3. Në aspektin e kërkimit dhe zhvillimit*

- Pedagogët kanë marrë pjesë individualisht në konferenca shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit.
- Është mbështetur stafi akademik ekzistues për vijimin e procesit të kërkimit shkencor dhe publikimit të punimeve me qëllim marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademik.
- Kolegji Universitar “LOGOS” ka rezultuar fitues në disa projekte të financuara nga BE.

### *4. Në aspektin e sigurimit të cilësisë*

- U aplikua politika e sigurimit të cilësisë e Kolegjit Universitar “LOGOS”.
- U kryen vlerësimet periodike për pedagogët dhe personelin akademik.
- U kryen vlerësimet periodike nga studentët për mësimdhënien dhe veprimtarinë e departamenteve.

## **Sfidat kryesore 2018 - 2024**

Kolegji Universitar “LOGOS” ndeshi disa sfida:

- Sfida për realizimin e mësimin në distancë (periudha COVID 19)
- Sfida për kthimin e vëmendjes së studentëve drejt shkencës duke pas nga ana tjetër sfidat që kanë të rinjtë e kësaj gjenerate në menaxhimin e kohës dhe objektivave të tyre.
- Sfida për rekrutimin e studentëve të rinj.
- Sfida e përshtatjes dhe zhvillimit të teknologjisë digjitale për procesin mësimor.

## **1.1 Struktura Akademike e Njërive**

Aktualisht Kolegji Universitar “LOGOS” përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor.

### **A. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara**

Struktura e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara që nga viti 2019

*(Departamentet janë riorganizuar në bazë të Vendimit Nr. 23, datë 11.09.2019 të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar “LOGOS”)*

1. Departamenti i Shkencave Mjekësore
2. Departamenti Informatikë e Zbatuar dhe Statistikë
3. Departamenti i Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale

### **B. Fakulteti Ekonomik**

Struktura e Fakultetit Ekonomik që nga viti 2019 *(Departamentet janë riorganizuar në bazë të Vendimit Nr. 23, datë 11.09.2019 të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar “LOGOS”)*

1. Departamenti Financë - Kontabilitet
2. Departamenti i Menaxhimit
3. Departamenti i Agrobiznesit

### **C. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor**

Struktura e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor që nga viti 2019 *(Departamentet janë riorganizuar në bazë të Vendimit Nr. 23, datë 11.09.2019 dhe Vendimit Nr.21, dt.15.10.2020 të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar “LOGOS”)*

1. Departamenti i Gjuhës dhe Civilizimit Grek;
2. Departamenti Theologjisë dhe Kulturës;
3. Departamenti Pedagogjisë dhe Psikologjisë.

## **1.2 Programet e studimit të Kolegjit Universitar “LOGOS”**

Programet e Kolegjit Universitar “LOGOS” synojnë të përgatisin specialistë për fusha vitale, si: të shëndetit, të ekonomisë, të arsimit, të mirëqenies sociale, të teknologjisë së informacionit, të teologjisë, të komunikimit, të agrobiznesit.

Para fillimit të aplikimit të strategjisë së re rezulton se: Kolegji Universitar “LOGOS” ofron 16 programe studimi, nga të cilat: (9) nëntë programe bachelor, tre programe master profesional, tre programe master shkencor dhe 1 program me karakter profesional 2 vjeçar. Të gjithë programet kanë status aktiv.

**(i)**

Më poshtë listohen programet e ciklit të parë të studimeve universitare të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”. Këto programe organizohet me 180 kredite ECTS, me kohë të plotë, me kohëzgjatje akademike 3-vjeçare. Studimet në këto program ofrohen në gjuhën shqipe, përveç programit “*Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek*”, i cili ofrohet në gjuhën greke. Këto programe studimi i takojnë nivelit të 6-të të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve:

*Programi i studimit “Bachelor në Financë-Kontabilitet”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Financë-Kontabilitet”.

*Programi i studimit “Bachelor në Menaxhim Biznesi”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Menaxhim Biznesi”.

*Programi i studimit “Bachelor në Menaxhim Turizmi”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Menaxhim Turizmi”.

*Programi i studimit “Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”.

*Programi i studimit “Bachelor në Informatikë të Zbatuar”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Informatikë të Zbatuar”.

*Programi i studimit “Bachelor në Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Studime në Teologji Sociale dhe Shkenca Religjioze”.

*Programi i studimit “Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek”.

*Programi i studimit “Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor”.

*Programi i studimit “Bachelor në Punë Sociale”*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Bachelor në Punë Sociale”.

**(ii)**

*Program studimi profesionale në ‘Agrobiznes’ me profile: Menaxhim i Fermës Bujqësore dhe Marketing i Produktit Bujqësor*. Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Profesionale në Agrobiznes me profil Menaxhim i Fermës Bujqësore” dhe “Diplomë Profesionale në Agrobiznes me profil Marketing i Produktit Bujqësor”.



**(iii)**

Programet e studimit Master Profesional janë programe me kohë të plotë, i referohen nivelit 7 (shtatë) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohen me 60 kredite ECTS dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1 (një) vit akademik:

*Programi i Ciklit të Dytë të studimit “Master Profesional” në Financë Kontabilitet* i pajis të diplomuarit me njohuri të thelluara profesionale në fushën e Financës dhe Kontabilitetit duke reflektuar dinamikën e zhvillimeve në disiplinat përbërëse të kurrikulës si dhe specifikat e kërkesës së tregut dhe të ekonomisë shqiptare.

*Programi i studimit “Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”* Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë”.

*Programi i studimit Master Profesional në “Theologji Sociale dhe Praktike”.* Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Master Profesional në “Theologji Sociale dhe Praktike”.

**(iv)**

Programet e studimit Master i Shkencave janë programe të ciklit të dytë të studimeve universitare. Ky program organizohet me 120 kredite ECTS, ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2-vite akademike, i referohen nivelit 7 (shtatë) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve:

*Programi i studimit Master i Shkencave “Turizëm Religjioz”*

Programi i studimit Master i Shkencave në “Turizmin Religjioz” Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Master i Shkencave në Turizmin Religjioz”.

*Programi i studimit Master i Shkencave në Përkthim Profesional*

Programi i studimit Master i Shkencave në “Përkthim Profesional”. Studimet në këtë program ofrohen në gjuhën shqipe, greke dhe angleze.

*Programi i studimit Master i Shkencave në Financë Kontabilitet.* Në përfundim të studimeve lëshohet “Diplomë Master i Shkencave në Financë Kontabilitet”.

**Në përfundim,** nga analiza e veprimtarisë së fakulteteve në fushën e kurrikulave dhe qëllimet për 6 vjeçarën e ardhshme, veprimtaria e Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor dhe Fakultetit të Shkencave të Aplikuara do të orientohet drejt konsolidimit dhe azhurnimit të programeve që ofron duke u përqendruar në përmirësimin e kurrikulave dhe të programeve mësimore të lëndëve si dhe pasurimin e ofertës akademike me programe të reja studimi, gjatë 6 viteve të ardhshme (2025-2030). Përmirësimet do të sjellin një vlerë të shtuar të pasqyruar në: vendosjen e balancës më të mirë sipas përqindjeve të kërkuara për lëndët sipas kategorive; adresimin e rekomandimeve nga ekspertët vlerësues dhe vendimet e

bordit të ASCAL; përmirësimin e programeve mësimore të lëndëve sipas zhvillimeve të kohës me tendencë drejt aplikimit, inovacionit, digjitalizimit, AI dhe shkencës së hapur.


***Tabela 1: Programet e studimit që ofron Kolegji Universitar “LOGOS”***

| PROGRAMET E STUDIMIT 2024-2025                        |                                                               |         |                                                                  |         |                                                                   |                           |
|-------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|---------|------------------------------------------------------------------|---------|-------------------------------------------------------------------|---------------------------|
| FAKULTETI EKONOMIK                                    |                                                               |         |                                                                  |         |                                                                   |                           |
| Nr.                                                   | Programi i studimit                                           | Kredite | Leja për hapjen                                                  | Statusi | Vendimi i akreditimit dhe riakreditimit                           | Vlefshmëria e akreditimit |
| 1                                                     | Bachelor në Financë-Kontabilitet                              | 180     | Urdhër nr.1, datë 06.01.2011                                     | Aktiv   | Vendim nr.71, datë 04.10.2019<br>Urdhër nr.282, datë 04.07.2012   | 30.09.2024<br>03.07.2018  |
| 2                                                     | Bachelor në Menaxhim Biznesi                                  | 180     | Urdhër nr.1, datë 06.01.2011                                     | Aktiv   | Vendim nr. 70, datë 15.03.2024<br>Urdhër nr.282, datë 04.07.2012  | 14.03.2030<br>15.03.2024  |
| 3                                                     | Bachelor në Menaxhim Turizmi                                  | 180     | Urdhër nr.396, datë 02.08.2010                                   | Aktiv   | Vendim nr.179, datë 25.11.2023<br>Urdhër nr. 282, datë 04.07.2012 | 24.11.2027<br>25.11.2023  |
| 4                                                     | Master Profesional në Financë-Kontabilitet                    | 60      | Urdhër nr.428, datë 22.09.2017<br>Urdhër nr.335, datë 16.08.2013 | Aktiv   | Vendim nr.50, datë 13.07.2018                                     | 30.09.2023                |
| 5                                                     | Profesional 2 vjeçar Agrobiznes me profile                    | 120     | Urdhër nr. 405 datë 25.07.2019                                   | Aktiv   | Vendim nr. 38 dt. 22.04.2022                                      | 21/04/2025                |
| 6                                                     | Master i Shkencave në Financë Kontabilitet                    | 120     | Urdhër nr. 445 datë 22.08.2024                                   | Aktiv   |                                                                   |                           |
| FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA                    |                                                               |         |                                                                  |         |                                                                   |                           |
| Nr.                                                   | Programi i studimit                                           | Kredite | Leja për hapjen                                                  | Statusi | Vendimi i akreditimit                                             | Vlefshmëria e akreditimit |
| 7                                                     | Bachelor në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë           | 180     | Urdhër nr.1, datë 06.01.2011                                     | Aktiv   | Vendim nr.178, datë 25.11.2023<br>Urdhër nr.282, 04.07.2012       | 24.11.2028<br>25.11.2023  |
| 8                                                     | Bachelor në Informatikë e Zbatuar                             | 180     | Urdhër nr.396, datë 02.08.2010                                   | Aktiv   | Vendim nr.221, datë 15.12.2023<br>Urdhër nr.282, datë 04.07.2012  | 14.12.2028<br>15.12.2023  |
| 9                                                     | Master Profesional në Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë | 60      | Urdhër nr.428, datë 22.09.2017<br>Urdhër nr.335, datë 16.08.2013 | Aktiv   | Vendim nr.49, datë 13.07.2018                                     | 30.09.2023<br>A3.07.2018  |
| FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHËSOR |                                                               |         |                                                                  |         |                                                                   |                           |
| Nr.                                                   | Programi i studimit                                           | Kredite | Leja për hapjen                                                  | Statusi | Vendimi i akreditimit                                             | Vlefshmëria e akreditimit |
| 10                                                    | Bachelor në Studime në Theologjinë                            | 180     | Urdhër nr.192, datë 20.04.2018                                   | Aktiv   | Vendim BA Nr. 84, datë 04.11.2022                                 | 03.11.2026                |

|    |                                                        |     |                                     |       |                              |             |
|----|--------------------------------------------------------|-----|-------------------------------------|-------|------------------------------|-------------|
|    | Sociale dhe Shkencat Religjioze                        |     |                                     |       |                              |             |
| 11 | Bachelor në Gjuhë dhe Civilizim Grek                   | 180 | Urdhër 433, datë 20.07.2018         | Aktiv | Vendim BA Nr. 69, 10.09.2022 | 09.09.2026  |
| 12 | Bachelor në Mësuesi në Arsimin Parashkollor            | 180 | Urdhër nr. 432, datë 20.07.2018     | Aktiv | Vendim BA Nr. 85, 04.11.2022 | 03.11.2026  |
| 13 | Bachelor në “Punë Sociale”                             | 180 | Urdhër MAS Nr. 455, datë 26.07.2022 | Aktiv | Nuk ka ende                  | Nuk ka ende |
| 14 | Master Profesional në “Theologji Sociale dhe Praktike” | 60  | Urdhër MAS Nr. 455 dt 14.08.2023    | Aktiv | Në proces                    | Nuk ka ende |
| 15 | Master i Shkencave në “Turizmin Religjioz”             | 120 | Urdhër MAS Nr. 374, datë 23.09.2021 | Aktiv | Në proces                    | Nuk ka ende |
| 16 | Master i Shkencave në “Përkthim Profesional”           | 120 | Urdhër MAS Nr. 596, datë 04.10.2022 | Aktiv | Në proces                    | Nuk ka ende |

Konsolidimi i programeve ekzistuese dhe ofrimi i programeve të reja do të jetë në fokus për vitet e ardhshme akademike. Programet e reja që do të propozohen do të studiohen me kujdes në përputhje me kuadrin kornizë të profesioneve, do të synojnë përmbushjen sa më të mirë të binomit ofertë-treg. Pasurimi i ofertës akademike me programe të reja do të orientohet drejt programeve të ciklit të dytë dhe njohjen e programeve të tij nga universitete të huaja partnere.

Në bazë të të dhënave statistikore, referuar numrit total të studentëve gjatë tre viteve të fundit vihet re një trend rritës i numrit të studentëve, për vitin akademik 2024-2025 ka një rritje rreth 10% krahasuar me vitin akademik 2023-2024 të numrit të përgjithshëm të studentëve. (Grafiku nr.1)



### 1.3 Personeli akademik në Kolegjin Universitar “LOGOS”

Kolegji Universitar “LOGOS” ka personel akademik, i cili është përmirësuar cilësisht ndër vite. Trupa akademike e angazhuar në Kolegjin Universitar “LOGOS” ka këto karakteristika kryesore: ***Pedagogë me kontribute të spikatura.*** Në Kolegjin Universitar “LOGOS” japin mësim pedagogë me formim nga një spektër i gjerë fushash studimi, të njohur për kontribute në mësimdhënie në arsimin e lartë, në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

***Pedagogë me ekspertizë.*** Kolegji Universitar “LOGOS” ka pedagogë me përvojë nga bota reale. Mbi 70% e tyre sjellin përvojën e gjatë dhe të pasur nga shëndetësia, biznesi, informatika, administrata publike, arsimi, organizata dhe kompani të ndryshme. Ata e ndërthurin teorinë me shembujt e përvojës nga bota reale dhe lidhjet e tyre mund t’u sigurojnë studentëve mundësi të vlefshme për profesionin dhe rrjetet profesionale.


***Pedagogë me formim dhe përvojë që përputhet me fushën e programit dhe lëndët mësimore.*** Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Ky tregues është përmirësuar gjatë viteve akademik 2021-2024 duke pajtuar pedagogë, formimi dhe përvoja e të cilëve përputhen mirë me lëndët mësimore të programit të studimit, me kërkesat për veprimtaritë laboratorike dhe drejtimin e praktikës profesionale.

***Mësimdhënie e nivelit të lartë.*** Pedagogët e Kolegjit Universitar “LOGOS” tregojnë një përkushtim të veçantë për të organizuar të nxënit e studentëve, bazuar në qasjen me në qendër studentin. Njohuritë, përvoja dhe përkushtimi i personelit akademik, të kombinuara me punën e studentëve, mbështesin zhvillimin e tyre si në aspektin akademik ashtu edhe personal. Kjo i ndihmon studentët që të jenë gati për fitimin e diplomës dhe vazhdimin e studimeve të mëtejshme ose të futen në botën e punës.

***Raporti studentë-pedagog.*** Me një raport studentë – pedagog në Kolegjin Universitar “LOGOS” 2,2:1, studentët njohin personalisht pedagogët. Pedagogët nuk janë vetëm mësimdhënës, por janë, gjithashtu, këshilltarë dhe mentorë të besuar. Ata madje mund të ndihmojnë studentët të kryejnë projektin kërkimor - një mundësi kjo që nuk ofrohet kudo për studentët universitar. Studentët marrin vëmendjen që u nevojitet për të arritur sukses në shkallën më të lartë.

***Personel ndërkombëtar.*** Kolegji Universitar “LOGOS” ka personel akademik ndërkombëtar që ofron një ekspertizë ndërkombëtare në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Të studiosh me pedagogë cilësorë, të përfitosh nga përvoja e pedagogëve me karrierë të gjatë në mësimdhënie, kërkime dhe me kontribut social, të mësosh gjuhë të huaja nga folës të gjuhës amtare është garanci për cilësinë e studimeve. Gjatë viteve akademike 2021-2024, Kolegji Universitar “LOGOS” ka patur personel akademik me kohë plotë që ka kryer së paku një cikël studimesh në universitete ndërkombëtare rreth 30 % dhe personel akademik me kohë të pjesshme rreth 45%.

Grafiku në vijim jep një pamje më të detajuar të cilësisë së personelit akademik në periudhën 2021 – 2025, sipas kategorive, shtjelluar në analizën e mëposhtme.



*Grafiku nr.2. Cilësia e personelit akademik në periudhën 2021 - 2025*

**Rritja e numrit të anëtarëve të personelit akademik.** Numri total i personelit akademik ka pasur një rritje progresive, duke kaluar nga 113 në vitin 2021-2022 në 125 në vitin 2024-2025. Kjo është një rritje e konsiderueshme prej rreth 10% anëtarësh në katër vite. Rritja tregon një zhvillim pozitiv, si rrjedhojë e rritjes së ofertës akademike të institucionit apo edhe një angazhim më të madh dhe mundësi më të shumta për kërkime shkencore, zhvillim profesional, dhe mbështetje të studentëve.

**Përmirësimi i strukturës cilësore të personelit akademik.** Rritja e numrit në kategorinë profesorë (Prof.Dr dhe Prof.Asoc.) ka pasur një qëndrueshmëri, duke u rritur nga 10% dhe 17% në vitin 2021-2022, në 11% dhe 15% në vitin 2024-2025.

**Rritja e numrit në kategorinë lektorë dhe asistent-lektorë.** Lektorët dhe asistent-lektorët përbëjnë pjesë të rëndësishme të personelit akademik (42% dhe 41% përkatësisht në vitin 2021-2022 dhe 2023-2024). Në kategorinë asistent-lektorë, në këto 3 vitet e fundit, 50% e tyre janë në proces doktoreture. Përfshirja në këtë proces ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së personelit akademik në të gjitha aspektet, qoftë zhvillimit të tyre personal, ashtu edhe mbështetjes më të mirë të studentëve, duke plotësuar edhe kërkesat e arsimit të lartë.

Në përgjithësi, grafiku tregon një rritje të qëndrueshme të numrit të personelit akademik, duke përfshirë të gjitha kategoritë dhe mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin e tij. Kjo është një shenjë pozitive e përkushtimit për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe përgatitjen e një brezi të ri akademik.

## 1.4 Kërkimi shkencor dhe Sigurimi cilësisë

### 1.4.1 Kërkimi Shkencor

Shtylla e Kërkimit shkencor fokusohet në veprimtaritë kërkimore – shkencore me karakter akademik dhe të aplikuar, në hartimin dhe zbatimin e projekteve, veprimtaritë e inovacionit, konsulencës, ekspertizës etj. Kërkimi bazë si pjesë e kërkimit shkencor në Kolegjin Universitar “LOGOS” synon të përmirësojë teoritë, të kuptuarit dhe të menduarit, parashikimin rreth fenomeneve të natyrës, shoqërisë, ekonomisë etj. I nxitur nga kurioziteti dhe dëshira për njohuri të reja, kërkimi bazë shërben si karburant i novacioneve të shkencave të aplikuara që studiohen në ciklet e programeve në Kolegjin Universitar “LOGOS”. Kërkimi bazë në Kolegjin Universitar “LOGOS” është i lidhur ngushtë me eksperiencën akademike dhe ka një ndikim të madh në jetën dhe të ardhmen studentore, sepse ai përditëson dijet e marra nëpërmjet projekteve dhe proceseve të mirëfillta kërkimore, detyrave të kursit, tezave kërkimore, duke provuar me prova dhe eksperimente dijet e fituara, si dhe duke zbuluar e identifikuar gjetje e rekomandime të vlefshme për grupet e interesit që studiohen.


### 1.4.2 Botime shkencore

**Analiza e kërkimit shkencor në Kolegjin Universitar “LOGOS” në periudhën (2020-2024) tregon disa prirje dhe dinamika për:**

1. **Botimet në revista shkencore; Revista me faktor impakti:** Rritja në mënyrë të qëndrueshme e numrit të botimeve nga 7 botime në 2020-2021 në 16 në 2023-2024, gjë që tregon një orientim drejt cilësisë në publikimet shkencore. **Revista brenda vendit:** Trend në rritje, duke arritur kulmin në 2023-2024 me 23 botime, nga 18 në 2020-2021.
2. **Konferencat shkencore;** Rritje e ndjeshme e numrit të pjesëmarrjeve në konferenca çdo vit, nga 44 në 2020-2021 në 101 në 2023-2024. Ky është tregues i një angazhimi më të madh në shkëmbimin shkencor dhe bashkëpunimin akademik.
3. **Libra dhe monografi;** Vihet re një stabilitet në botimin e librave dhe monografive, me një mesatare prej 8 botimesh në vit.
4. **Pjesëmarrja në aktivitete shkencore dhe projekte;** Parë në disa drejtime konstatohet që;  
a) Projektet kërkimore-shkencore dhe përfitimi i financimeve konkurruese kanë pasur rritje të konsiderueshme, veçanërisht në vitin 2023-2024, ku janë regjistruar 23 raste, krahasuar me 6 në 2020-2021. b) Projekte të financuara nga donatorë të huaj kanë qenë të pakta, por me një prirje në rritje, duke arritur 5 në 2023-2024. c) Drejtimi i komiteteve organizuese të konferencave ka pasur një trend të qëndrueshëm, me një rritje të lehtë në fundin e periudhës.

Pas analizës, vërehet se Kolegji Universitar “LOGOS” ka pasur një rritje të dukshme të aktiviteteve kërkimore, sidomos në publikimet me faktor impakti dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore gjatë periudhës 2020-2024.

**Grafiku 3: Numri i publikimeve për periudhën 2020-2024**



Shënim: Për vitin akademik 2023-2024 informacioni përfshin të dhëna deri në fund të vitit 2024

## 1.5 Sigurimi Cilësisë

### ***Sigurimi i brendshëm i cilësisë***

Kolegji Universitar “LOGOS” në zbatim të parimeve të përgjegjshmërisë dhe të transparencës ka ngritur një strukturë në nivel institucioni, e emërtuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucioni është një strukturë ndihmës-akademike me karakter administrativ që ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi bashkëpunon me Komisionin e Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe është në varësi të Rektorit të Kolegji Universitar “LOGOS”.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka vlerësuar, periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Gjatë viteve akademik 2018-2024, para sezonit të provimeve finale për çdo semestër janë organizuar vlerësimet nga studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me Zyrën për Çështjet Studentore dhe Karrierës ka kryer studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji Universitar “LOGOS”.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë gjatë viteve akademike 2018-2024 ka përgatitur raporte për vlerësimin e mësimdhënies së pedagogëve nga studentët dhe rezultatet e tyre përmes përgjegjësve të departamenteve respektive iu janë përcjellë individualisht pedagogëve.

Bazuar në Nenin 16, pika 3/1 të Rregullores së Sigurimit të Cilësisë, NJSBC e Kolegjit Universitar “LOGOS” ka organizuar veprimtari periodike me personelin dhe studentët e Kolegjit Universitar



“LOGOS” për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit, nëpërmjet:

- Në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë është organizuar seminari i trajnimit “Ndërkombëtarizimi: Prire Evropiane, Rajonale dhe të Ne. Modul Diskutimi dhe Zhvillimi për Stafin Akademik & Administrativ”.
- Pjesëmarrja në seminarin publik (28.04.2023) për njohjen automatike, në kuadrin e “Bologna Thematic Peer Group B on Key Commitment 2: National legislation and procedures compliant with the Lisbon Recognition Convention.”
- Pjesëmarrje në Erasmus+ Programme MAGNET: In-person Kickoff Meeting (Alexandroupolis).
- Pjesëmarrje në konferencën “Cikle të të Nxënës në Pedagogjinë Universitare,” Universiteti Demokrit i Thrakës.
- Anëtarësimi si anëtar themelues në Rrjetin Ballkanik të Pedagogjisë Universitare. Trajnimi i stafit të ri akademik të përfshirë në strukturat e sigurimit të cilësisë për përfitimin e përvojës në këtë drejtim me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë gjithmonë e më të gjerë në institucion.

## **1.6 Infrastruktura didaktike dhe Biblioteka**

### **1.6.1 Laboratorët në dispozicion**

Kolegji Universitar “LOGOS” ka vënë në dispozicion të kërkimit shkencor 11 laboratorë (atelie për pedagogjinë, laborator i gjuhës greke, 5 laboratorë të teknikës së lartë të laboratorëve dhe 3 laboratorë të informatikës si dhe një laborator për përpunimin e të dhënave ekonomike). Gjithashtu, në ndihmë të realizimit të synimeve të kërkimit shkencor janë dy biblioteka me fondin e tyre të materialeve të printuara dhe digjitale.

Infrastruktura mbështetëse e kërkimit shkencor përfshin njësi kompjuterike dhe akses në një sërë databazash elektronike në të cilat merr pjesë biblioteka institucionale (p.sh. JSTOR dhe EBSCO), por edhe në disa databaza të veçanta për hulumtim theologjik, të tillë si *Diogenes*, *Tesaurus Linguae Graecae* dhe *BibleWorks*.

Duke analizuar veprimtarinë kërkimore të zhvilluar gjatë vitit akademik 2022-2023, arrijmë në përfundimin se duhet punuar për të përcaktuar fushat e projekteve të kërkimit; për të përcaktuar projektet konkrete të kërkimit në nivel departamenti dhe fakulteti.

Në këtë kuadër, sfidë e vazhdueshme mbetet që kërkimi i studentëve të lidhet me projektet e kërkimit të departamentit, gjë që ende është një sfidë. Ky është një synim që do të jetë në fokus edhe në vitet që vijnë derisa të arrijmë që të krijojmë traditën në këtë aspekt. Kështu studentët do të jenë të aftë të përfshihen në veprimtarinë reale kërkimore të Kolegjit.

Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm parashikon fonde lidhur me kërkimin shkencor si dhe trajnimin apo rritjen profesionale te personelit akademik.

## 1.6.2 Biblioteka

Në kampusin Tiranë ndodhet Biblioteka me sipërfaqe 173 m<sup>2</sup> me 40 poste leximi si dhe 18 poste të pajisura me kompjuter e rikonstruktuar dhe riorganizuar plotësisht në fund të vitit 2019.

Në kampusin Shën Vlash ndodhet Biblioteka me sipërfaqe 118 m<sup>2</sup> me 20 poste leximi dhe 6 poste për përdorim kompjuteri.

Vëmendje e veçantë i kushtohet Bibliotekës si dhe pasurimit të vazhdueshëm të saj me tituj e libra të rinj, të nevojshëm dhe të përshtatshëm sipas programeve të studimit. Çdo vit në buxhet është parashikuar një fond i konsiderueshëm në dispozicion të bibliotekës.

Nga viti 2018 e deri ne përfundim të vitit 2024 Biblioteka e Kolegjit Universitar “LOGOS” është shndërruar totalisht.

Numri i librave dhe titujve është rritur disa herë. Infrastruktura ka ndryshuar ndjeshëm pasi është ndërtuar Biblioteka e re në mjediset e Kampusit Nr.1, Tiranë si dhe është shtuar nga fillimi Biblioteka e Kampusit Nr.2, Shën Vlash – Durrës.

Deri në fund të vitit 2024, Biblioteka e Kolegjit Universitar LOGOS numëron:

- **Libra:** 26,652
- **Tituj:** 23,140
- **Periodikë:** 183 tituj (11 shqip, 23 greqisht, 7 anglisht)
- **Materiale jo libra:** 478 njësi (CD, DVD, etj.)

### *Akses në Bibliotekat Online*

- **PubMed.gov:** Në bashkëpunim me IAL private.
- **JSTOR dhe EBSCO:** Në bashkëpunim me IAL publike.
- **Platforma elektronike për programin “Gjuhë dhe civilizim grek”:** elearn.pi.ac.cy.

Katalogu elektronik <http://lib-orthodoxalbania.org> ndihmon cilindo në gjetjen e informacionit që disponon fondi i bibliotekës. Kolegji Universitar “LOGOS” ofron akses në literaturën online të bibliotekës ndërkombëtare Questia Online Library: [www.questia.com](http://www.questia.com). Kjo bibliotekë ofron më shumë se 83 000 libra akademikë dhe mbi 10 milionë artikuj në shkencat ekonomike, mjekësorë, informatike etj. Gjithashtu Kolegji Universitar “LOGOS” në bashkëpunim me Universitetin e Pireut ofron akses në literaturën online të bibliotekës së këtij

Universiteti: <http://digilib.lib.unipi.gr/ket/>. Jemi në përfundim e sipër të marrëveshjes për përdorimin e bibliotekës së pasur digjitale online të Universitetit Aristoteli të Selanikut.

Një element i rëndësishëm për funksionimin e bibliotekës është edhe përdorimi i literaturës online. Për këtë arsye në bashkëpunim me departamentet përkatës, studentëve iu rekomandohen vazhdimisht adresa elektronike, të cilat iu duhen përgjatë studimeve dhe punës së tyre kërkimore. Ky proces merr rëndësi jo vetëm në aspektin profesional për punonjësit, por sidomos në atë të shërbimit ndaj lexuesit, sepse jo vetëm ofron komoditet, por shkurton në mënyrë të konsiderueshme kohë për marrjen e informacionit nga ana e përdoruesve të katalogut elektronik. Katalogu elektronik, në bazën e tij të të dhënave bart informacionin bibliografik në formatin MARC (Machine Readable Cataloging) për çdo njësi bibliotekare. Kompjuterizimi e bën mjaft të plotë edhe të shpejtë kërkimin në bazën e të dhënave. Në katalogun elektronik mund të kërkohet sipas: autorit, titullit, shtëpisë botuese, vendit, vitit të botimit apo një fjale kyçe. Katalogu elektronik do ndihmojë cilindo në gjetjen e informacionit që disponon fondi i bibliotekës së Kolegjit Universitar “LOGOS”.

Zhvillimi i koleksioneve të bibliotekës, realizohet nëpërmjet këshillimeve me dekanët, shefat e departamenteve dhe pedagogët me anë të blerjeve, huazimeve, shkëmbimeve, dhuratave etj. Biblioteka synon pasurimin e mëtejshëm të koleksioneve fizike dhe digjitale në disiplina të ndryshme shkencore, për të pasuruar mjedisin e kërkimit dhe mësimdhënies në Kolegjin Universitar “LOGOS”

## 2. Pikat e forta dhe të dobëta pas Analizës së Situatës Aktuale

### 2.1 Pikat e Forta

- **Stafi Akademik:** Kolegji Universitar LOGOS ka një staf akademik të përkushtuar dhe me përvojë të pasur në fushat e tyre përkatëse, gjë që siguron një cilësi të lartë në mësimdhënie, duke i ofruar studentëve jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike dhe përgatitje për sfidat profesionale. Përveç kësaj, stafi angazhohet në kërkime shkencore të rëndësishme, duke kontribuar në zhvillimin e dijeve dhe avancimin e praktikave akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- **Infrastruktura:** Institucioni ofron një infrastrukturë moderne dhe të mirëorganizuar që synon të plotësojë nevojat e studentëve dhe stafit akademik. Ambientet përfshijnë laboratorë digjitale të avancuar, të pajisur me teknologjinë më të fundit, që u mundësojnë studentëve të zhvillojnë aftësi praktike dhe të përfshihen në projekte inovatore në fusha të ndryshme. Biblioteka është e pasur me literaturë bashkëkohore, duke përfshirë libra, revista shkencore, dhe akses në platforma digjitale ndërkombëtare. Ky kombinim i teknologjisë, hapësirave bashkëkohore dhe

burimeve të pasura synon të krijojë një mjedis që inkurajon krijimtarinë, përkushtimin dhe suksesin akademik.

- **Programet e Studimit:** Programet e studimit të ofruara nga institucioni ynë janë të akredituara dhe të njohura ndërkombëtarisht duke rritur jo vetëm besueshmërinë dhe atraktivitetin e Kolegjit për studentët e ardhshëm, por edhe mundësitë e tyre për të pasur një karrierë të suksesshme në tregun global të punës. Gjithashtu, ndiqet me kujdes përditësimi i programeve ekzistuese si edhe studimi i tregut për programe të reja studimi. Ky proces përfshin monitorimin e trendeve globale në arsim dhe teknologji, konsultime me industrinë dhe vlerësimin e nevojave të studentëve dhe punëdhënësve.
- **Bashkëpunimet Ndërkombëtare:** Kolegji ka ndërtuar një rrjet të gjerë marrëveshesh bashkëpunimi me universitete dhe institucione të tjera arsimore e kërkimore në mbarë botën, të cilat synojnë të ofrojnë mundësi për shkëmbime studentore dhe projekte të përbashkëta kërkimore.

## 2.2 Pikat e Dobëta

- **Mungesa e Diversitetit të Studentëve:** Një përqindje e lartë e studentëve vijnë nga zona të afërta, duke kufizuar diversitetin kulturor, perspektivat e ndryshme dhe përvojat unike që mund të sjellin studentët nga rajone të tjera apo vende të ndryshme.
- **Marketingu dhe Promovimi:** Përforsimi i strategjive të marketingut dhe promovimit për të tërhequr një numër më të madh studentësh dhe për të rritur njohjen e markës së Kolegjit Universitar “LOGOS”.

## 2.3 Kërcënime

- **Vlerësimi i Konkurrencës dhe Trendet Aktuale në Fushën e Arsimit të Lartë.** Në fushën e arsimit të lartë konkurrenca është e ashpër, me shumë institucione që ofrojnë programe të ngjashme. Universitetet publike dhe private po përpiqen të tërheqin studentë, përmes ofertave të ndryshme akademike dhe përmirësimeve infrastrukturore. Trendet aktuale përfshijnë një fokus të shtuar në mësimdhënien online dhe hibride, zhvillimin e programeve të studimit që lidhen me teknologjinë dhe inovacionin, si dhe një rritje të kërkesës për programe të specializuara dhe të personalizuar që përputhen me zhvillimet më të fundit të tregut të punës. Për të qëndruar konkurrues, Kolegji Universitar “LOGOS” duhet të vazhdojë të investojë në teknologji të reja duke ofruar mësimdhënie inovative dhe platforma moderne, të rrisë marketingun, për të komunikuar më mirë përparësitë e tij unike ndaj studentëve potencialë, të zhvillojë programe të reja, të cilat adresojnë kërkesat në rritje të tregut dhe u japin përparësi studimeve ndërdisiplinare dhe praktikës profesionale, të forcojë lidhjet me industrinë dhe partnerët ndërkombëtarë, për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe praktikash për studentët.

- **Emigrimi i lartë i popullsisë**, veçanërisht i moshave të reja, është një fenomen që po ndikon vitet e fundit në uljen e numrit të regjistrimeve në universitete, efektet e të cilit ndihen patjetër dhe në Kolegjin Universitar “LOGOS”.
- **Ulja e lindshmërisë**: Një kërcënim është edhe ulja e numrit të nxënësve që vijnë çdo vit nga gjimnazi, një fenomen që lidhet ngushtësisht me uljen e popullsisë, e cila mund të ndikojë në numrin e mundshëm të regjistrimeve në të ardhmen.

## 2.4 Oportunitete

- Mundësitë e ofruara nga fondet e BE-së, për projekte në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve dhe infrastrukturës, në mësimdhënie e mësimnxënie. Kolegji Universitar “LOGOS”, synon të angazhohet në identifikimin, aplikimin dhe zhvillimin e projekteve, që janë në përputhje me nevojat e tregut dhe prioritetet e arsimit të lartë.

## 3. OBJEKTIVAT DHE STRATEGJITË 2025-2030

Strategjia për zhvillimin e Kolegjit Universitar “LOGOS”, përfshin disa faza, të cilat nisin me analizën e arritjeve të deritanishme për të evidentuar situatën ku jemi në përputhje me vizionin dhe misionin, përcaktohen objektivat dhe strategjitë kryesore për periudhën 2025-2030.

### 3.1 Vizioni, misioni, vlerat thelbësore

Kolegji Universitar “LOGOS” do të vijojë të udhëhiqet nga vizioni, misioni dhe vlerat themelore të ravijëzuara nga themeluesi, Fortlumenturia e Tij, Prof. Dr. Anastasios Yannoulatos. Ato janë:

**Vizioni:** “Kolegji Universitar “LOGOS” synon të jetë një qendër moderne e të mësuarit dhe e kulturës për transformimin e jetëve.”

**Misioni:** “Misioni i Kolegjit Universitar “LOGOS” është t’i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimimit, hulumtimit, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve, sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global, ofrimin e shërbimeve akademike dhe zhvillimin e një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.”

**Vlerat thelbësore:** **Të mësuarit** pajis të diplomuarit për të jetuar jetë të shëndetshme, racionale, krijuese, produktive dhe parimore; **Përsosmëri akademike** është siguri i përvojave më të larta të arsimit dhe të të mësuarit, të mundësuar nga pedagogë dhe staf mësimesor akademikisht dhe profesionalisht të kualifikuar, mundësi për të nxënësit kontekstual, infrastrukturë mësimore mbështetëse, mjedis të bukur dhe burime efektive të nevojshme për të mbështetur të mësuarit në nivelin më të lartë; **Përgjegjësia** shihet në lidhje me detyrën e marrjes së vendimeve bazuar në kontekst dhe duke mbajtur parasysh pasojat e veprimeve; **Integriteti** përfshin ndershmërinë dhe drejtësinë, qëndrueshmërinë në mësimdhënie, etikën e bursave, lirinë e hetimit dhe angazhimin e hapur dhe të sqartë me komunitetin përmes komunikimit, politikave dhe praktikave efektive;

**Diversiteti** si ndryshim i kuptimit, zhvillon respektin për pluralizmin etnik, kulturor dhe fetar; një ndërgjegje ndërkombëtare; dhe një vlerësim për vlerën e pafund të çdo personi; pasuron një ambient mësimi të fokusuar në përgatitjen e individëve për të jetuar dhe punuar në një shoqëri globale.

## 3.2 Përcaktimi i Objektivave Strategjike

### 3.2.1 Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit

- **Përditësimi dhe Zhvillimi i Kurrikulave Inovative:** Përditësimi dhe zhvillimi i kurrikulave që përputhen me nevojat e tregut të punës dhe që nxisin mendimin kritik dhe kreativitetin.
- **Trajnimi i Stafit Akademik:** Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin akademik për të përmirësuar metodat e mësimdhënies dhe për të integruar teknologjitë e reja në procesin mësimor.
- **Rritja e Mbështetjes për Studentët:** Zhvillimi i programeve mbështetëse për studentët, përfshirë këshillimin akademik dhe profesional, për të siguruar suksesin e tyre akademik dhe personal.
- Kolegji Universitar “LOGOS”, synon shndërrimin në një institucion të orientuar drejt përdorimit të teknologjisë së informacionit në proceset akademike, komunikimin me studentët dhe aktorët e tjerë, ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe ofrimin e shërbimeve për studentët dhe palët e treta.
- Kolegji Universitar “LOGOS”, synon zhvillimin e programeve të formimit të vazhdueshëm dhe trajnimeve. Ky qëllim do të realizohet përmes modeleve të kombinuara (online dhe të drejtpërdrejta) për mësimdhënie dhe nxënie, duke mbështetur konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Këtu përfshihen programe afatshkurtra për kualifikime, specializime, përditësim të dijeve dhe zhvillim profesional gjatë karrierës.
- Kolegji Universitar “LOGOS”, synon zhvillimin e kërkimit shkencor aplikativ në bashkëpunim të ngushtë me njësitë bazë dhe me nevojat e ekonomisë, shoqërisë dhe sipërmarrjes.
- Procesi akademik do të zhvillohet në formë të kombinuar (hibrid), duke integruar teknologjitë digjitale, platforma për mësimdhënie dhe ndërveprimin aktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve në auditorë, gjithmonë në përputhje me kuadrin rregullativ në fuqi.
- Për të realizuar misionin e tij, Kolegji Universitar “LOGOS” do vazhdojë të bashkëpunojë dhe të lidhë marrëveshje me institucione publike dhe private për aktivitete të përbashkëta didaktike, praktika mësimore, kërkime shkencore, konsulenca dhe shërbime për palë të treta.

### 3.2.2 Stabiliteti dhe rritja e qëndrueshme e regjistrimeve

- **Strategji Marketingu:** Zhvillimi i strategjive të marketingut që synojnë ruajtjen dhe rritjen e qëndrueshme të studentëve të rinj nga rajone të ndryshme dhe nga jashtë vendit.
- **Zgjerimi i Ofertës Akademike:** Ofrimi i programeve të reja studimi që janë në përputhje me kërkesat e tregut dhe interesat e studentëve potencialë.
- **Bursa dhe Ndihma Financiare:** Përpjekje të vazhdueshme në përputhje me frymën e Fondacionit LOGOS për akordimin e bursave dhe ndihmës financiare në mbështetje të studentëve me rezultate të larta si dhe atyre me nevoja ekonomike.

### 3.2.3 Përshtatshmëria me Vizionin dhe Misionin

Të gjitha objektivat strategjike të përcaktuara janë në përputhje të plotë me vizionin dhe misionin e Kolegjit Universitar “LOGOS”. Duke përmirësuar cilësinë e arsimit, rritur regjistrimet dhe përmirësuar kërkimin shkencor, ne synojmë të bëhemi një qendër e njohur ndërkombëtarisht për ekselencën akademike dhe kërkimore. Këto objektiva do të na ndihmojnë të përmbushim misionin tonë për të ofruar një edukim cilësor, për të nxitur inovacionin dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

### 3.2.4 Rritja e Ndërkombëtarizimit

Përmes rritjes së kapaciteteve të stafit për ndërkombëtarizim, synohet eksplorimi i mundësive për programe studimi të përbashkëta dhe mobilitete afatgjata, me fokus kryesor ciklin e dytë të studimeve. Synohet mbështetja e kërkimeve të përbashkëta shkencore, si edhe ndërkombëtarizimi përmes shkëmbimit të stafit dhe studentëve, e mësimdhënies.

### 3.2.5 Kërkimi dhe inovacioni

Kolegji Universitar “LOGOS”, synon të orientojë kërkimin shkencor drejt aplikimeve praktike në jetën shoqërore dhe ekonomike duke nxitur inovacionin dhe aftësimin e vazhdueshëm të kapitalit njerëzor. Qëllimi është krijimi i mundësive të reja dhe fuqizimi i ekspertizës, përmes zhvillimit të shërbimeve dhe proceseve inovative. Kërkimi i aplikuar do të përfshijë përdorimin e njohurive dhe teknologjive më të fundit, për kryerjen e studimeve të vizibilitetit dhe konsultimeve teknike, si dhe hulumtimet e tregut në shërbim të biznesit, industrisë dhe komunitetit. Gjithashtu, puna e stafit akademik në Kolegjin Universitar “LOGOS”, do të ndërtohet edhe mbi bazën e rezultateve në kërkimin shkencor dhe zbatimit të dijeve të fituara. Institucioni synon bashkëveprimin e ngushtë me bizneset dhe industrinë, për të zhvilluar projekte dhe për të adresuar sfidat praktike të këtyre sektorëve.

**Nxitja e Projekteve Kërkimore:** Mbështetja dhe financimi i projekteve kërkimore, që kanë ndikim të rëndësishëm në fushat përkatëse dhe që kontribuojnë në zhvillimin e njohurive.

**Bashkëpunimet Ndërkombëtare:** Zgjerimi i bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare, për të rritur mundësitë për projekte të përbashkëta dhe shkëmbime akademike.

**Publikimet Shkencore:** Inkurajimi dhe mbështetja financiare e stafit akademik, për të publikuar punimet e tyre në revista shkencore me reputacion dhe për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare.

### **3.2.5.1 Kërkimi Ndërdisiplinor**

Fakultetet dhe stafi akademik i Kolegjit Universitar “LOGOS”, do të promovojnë kërkimin ndërdisiplinor, duke krijuar dije të reja që mbështesin përmirësimin e kurrikulave universitare dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale. Bashkëpunimi me komunitetin dhe industrinë, sigurojnë zbatimin praktik të rezultateve të kërkimit përmes trajnimeve, kualifikimeve dhe projekteve zhvillimore.

### **3.2.5.2 Inovacioni i Hapur**

Përmes konceptit të inovacionit të hapur, Kolegji Universitar “LOGOS” synon të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve publikë dhe private, për të krijuar dhe shpërndarë zgjidhje të reja përtej kufijve tradicionalë. Pjesëmarrja e Kolegjit Universitar “LOGOS”, në platforma si OASIS do mbështesë këto përpjekje, duke sjellë në jetë konceptin e inovacionit të hapur dhe duke ndihmuar në zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme.

## **4. STRATEGJITË KRYESORE**

### **4.1 Përmirësimi i Cilësisë së Arsimit**

*Strategjia për Përmirësimin e Cilësisë së Mësimdhënies dhe të Nxënies.*

Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies në Kolegjin Universitar “LOGOS” do të ndjekim një qasje të integruar që përfshin elementët e mëposhtëm:



#### **4.1.1 Përditësimi i Kurrikulave:**

Rishikimi dhe përditësimi i kurrikulave për të siguruar që ato janë në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse dhe me kërkesat e tregut të punës.

Si do të veprohet:

- Përfshirja e Feedback-ut: Mbledhja e mendimit të studentëve, stafit akademik dhe aktorëve të jashtëm (si punëdhënës dhe alumni), për të siguruar që kurrikulat pasqyrojnë nevojat reale të tregut të punës.
- Harmonizimi me Standardet Ndërkombëtare: Kurrikulat do të përditësohen duke marrë në konsideratë standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe modelet e suksesshme në universitete prestigjioze.
- Fokusimi në Kompetencat Praktike: Do të integrohen module praktike, internship-e dhe projekte reale, që ndihmojnë studentët të fitojnë aftësi të zbatueshme në tregun e punës.

#### **4.1.2 Integrimi i Teknologjisë në Mësimdhënie:**

Përdorimi i teknologjive të reja dhe platformave digjitale, për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe për të ofruar një përvojë më të angazhuar dhe interaktive për studentët.

Si do të veprohet:

- Adoptimi i Platformave Digjitale: Përdorimi i platformave si Microsoft Teams, për të lehtësuar mësimdhënien dhe për të përmirësuar përvojën e studentëve.
- Krijimi i Klasave Online dhe Hibride: Do të zhvillohen kurse që kombinojnë mësimin në klasë me mësimin online, për t'u përshtatur me stilin dhe nevojat e ndryshme të studentëve.
- Trajnimi i Stafit për Teknologjitë e Reja: Stafi pedagogjik do të trajnohet për përdorimin efektiv të platformave digjitale dhe aplikacioneve që ndihmojnë në menaxhimin e klasave dhe vlerësimin e studentëve.
- Integrimi i Mjeteve të Realitetit Virtual dhe Artificial: Laboratorët virtualë dhe simulimet do të përdoren në fusha aplikative si shkencat e komunikimit, informatike, mjekësi etj.

#### **4.1.3 Metodatat Inovative të Mësimdhënies:**

Zbatimi i metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies, si mësimi i bazuar në projekte, mësimi i përmbysur dhe mësimi i bazuar në probleme, për të nxitur mendimin kritik dhe kreativitetin tek studentët.

Si do të veprohet:

- Mësimi i Bazuar në Projekte: Do të zhvillohen module që kërkojnë nga studentët të punojnë në projekte reale ose simulime biznesi.
- Mësimi i Përmbytur (Flipped Classroom): Seminaret do të jenë të aksesueshme online, duke u fokusuar më shumë në diskutime dhe aktivitete praktike gjatë orëve në klasë.
- Mësimi i Bazuar në Probleme (Problem-Based Learning - PBL): Studentët do të trajnohen për të zgjidhur probleme komplekse dhe për të bashkëpunuar në mënyrë efektive në ekipe.
- Organizimi i Forumeve të Diskutimit: Përmes debateve dhe forumeve të moderuara, do të nxitet mendimi kritik dhe angazhimi i studentëve.

#### 4.1.4 Vlerësimi i Performancës Akademike:

Zhvillimi i mekanizmave të rregullt për vlerësimin e performancës akademike të studentëve dhe stafit, për të identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim dhe për të siguruar cilësinë e mësimdhënies.

Si do të veprohet:

Do të vijohet me

- Vlerësimi i Mësimdhënies nga Studentët: Do vijohet me krijimin e mekanizmave për studentët, që të japin feedback mbi cilësinë e mësimdhënies dhe materialeve të përdorura.
- Analiza e Performancës së Stafit: Përdorimi i indikatorëve të performancës, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të stafit, duke përfshirë vlerësime nga kolegët dhe studentët.

#### 4.1.5 Trajnimi i Stafit Akademik

Planet e Trajnimit për Stafin Pedagogjik dhe Përmirësimi i Infrastrukturës së Mësimi

- **Programet e Trajnimit të Vazhdueshëm:** Organizimi i programeve të trajnimit të vazhdueshëm për stafin pedagogjik, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimore mësimdhënëse dhe për të integruar teknologjitë e reja në procesin mësimor.
- **Workshop-e dhe Seminare:** Mbajtja e workshop-eve dhe seminareve të rregullta, për të ndarë praktikën më të mirë dhe për të diskutuar zhvillimet e fundit në fushën e arsimit.
- **Mentorimi dhe Mbështetja:** Krijimi i programeve të mentorimit dhe mbështetjes për stafin e ri pedagogjik, për të siguruar një tranzicion të suksesshëm dhe për të ndihmuar në zhvillimin e tyre profesional.

Si do të veprohet:

- Programet e Certifikimit: Do të vijohet me trajnime dhe certifikime për të rritur njohuritë pedagogjike dhe teknologjike të stafit.
- Partneritetet me Universitete Ndërkombëtare: Do të vijohet bashkëpunimi për shkëmbime akademike dhe seminare të përbashkëta.
- Vlerësimi i vazhduar: Pas çdo trajnime, stafi do të testohet për efektivitetin e tij dhe zbatimin praktik të aftësive të fituara.

#### **4.2 Përmirësimi i Infrastrukturës së Mësimi:**

- **Modernizimi i Laboratorëve dhe Bibliotekave:** Investimi në modernizimin e vazhduar të laboratorëve dhe bibliotekave, për të siguruar që studentët dhe stafi kanë qasje në pajisjet dhe burimet më të fundit.
- **Zhvillimi i Hapësirave të Reja Mësimore:** Krijimi i hapësirave të reja mësimore që janë të përshtatshme për metodat e reja të mësimdhënies dhe që ofrojnë një mjedis të rehatshëm dhe të frytshëm për mësim.
- **Pajisjet Teknologjike:** Sigurimi i pajisjeve teknologjike të avancuara, si kompjuterë, projektorë dhe pajisje të tjera digjitale, për të mbështetur procesin e mësimdhënies dhe të nxënies.

Si do të veprohet:

- Do të vijojë pasurimi i bibliotekës dhe do të modernizohet me pajisje të reja, duke përfshirë sisteme të avancuara kompjuterike dhe qasje në burime të fundit akademike online.
- Krijimi i Hapësirave Inovative: Do të ndërtohen klasa fleksibël dhe hapësira bashkëpunimi për studentët, duke integruar teknologji si ekranet interaktive dhe mobiljet e lëvizshme.
- Krijimi i hapësirave rekreative për studentët dhe stafin.

#### **4.3 Monitorimi për sigurimin e brendshëm të cilësisë**

Strategjia e Kolegjit Universitar “LOGOS”, gjatë periudhës 2025-2030 për sigurimin e cilësisë mbështetet në këto objektiva kryesore:

- Realizimi i vlerësimit të cilësisë për akreditimin institucional dhe për akreditimin e programeve të studimit;
- Sigurimi i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës.
- Marrja e masave për proceset e akreditimit institucional dhe akreditimin e programeve të studimit.
- Përbushja e standardeve për sigurimin e cilësisë.
- Kontrolli dhe rritja e cilësisë nëpërmjet veprimtarive dhe masave të përshtatshme.

## 4.4 Të vijohet me Analizën e tregut për çdo program studimi

### 4.4.1 Analizë e tregut për çdo program studimi

Për të kuptuar më mirë tregun e arsimit të lartë dhe për të identifikuar mundësitë për rritje dhe zhvillim, është e nevojshme të kryhet një analizë e tregut për çdo program studimi. Kjo analizë përfshin:

1. **Studimi i Tendencave të Tregut:** Identifikimi i trendeve aktuale në arsimin e lartë, përfshirë rritjen e kërkesës për programe online dhe hibride, zhvillimin e programeve të specializuara dhe rritjen e interesit për fushat e teknologjisë dhe inovacionit.
2. **Analiza Demografike:** Studimi i demografisë së studentëve potencialë, përfshirë moshën, gjininë, vendndodhjen gjeografike dhe sfondin socio-ekonomik, për të kuptuar më mirë grupet e synuara.
3. **Vlerësimi i Konkurrencës:** Analiza e konkurrentëve aktualë dhe potencialë në tregun e arsimit të lartë, përfshirë universitetet publike dhe private dhe identifikimi i avantazheve dhe disavantazheve të tyre.

### 4.4.2 Segmentimi i Studentëve

Pasi të kemi kryer analizën e tregut, është e rëndësishme të segmentojmë studentët potencialë në grupe të ndryshme, bazuar në nevojat dhe preferencat e tyre. Segmentimi mund të përfshijë:

1. **Studentët e Nivelit të Parë:** Studentët që sapo kanë përfunduar shkollën e mesme dhe kërkojnë të ndjekin studimet e larta. Këta studentë zakonisht kërkojnë programe të akredituara, mundësi për zhvillim personal dhe profesional dhe një mjedis të sigurt dhe mbështetës.
2. **Studentët e Nivelit të Dytë dhe të Tretë:** Studentët që kërkojnë të ndjekin studimet master ose doktoraturë. Këta studentë janë të interesuar për programe të avancuara, mundësi kërkimore dhe bashkëpunime ndërkombëtare.
3. **Studentët Ndërkombëtarë:** Studentët nga vende të tjera që kërkojnë të studiojnë në Shqipëri. Këta studentë kërkojnë programe të njohura ndërkombëtarisht, mbështetje për integrimin kulturor dhe mundësi për shkëmbime akademike.
4. **Studentët e Rritur dhe Profesionalistët:** Individët që kërkojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre ose të ndryshojnë karrierën. Këta studentë kërkojnë programe fleksibile, mundësi për mësim online dhe mbështetje për zhvillim profesional.

#### 4.4.2.1 Identifikimi i Nevojave dhe Preferencave të Segmenteve

Për të përmbushur nevojat dhe preferencat e segmenteve të ndryshme të studentëve, është e rëndësishme të:

1. **Zhvillojmë Programe:** Ofrimi i programeve të studimit, që janë të përshtatura për nevojat specifike të secilit segment, duke përfshirë programe të specializuara.
2. **Sigurojmë Mbështetje Akademike dhe Sociale:** Ofrimi i shërbimeve mbështetëse, si këshillimi akademik, mbështetja psikologjike dhe mundësitë për zhvillim personal dhe profesional.
3. **Përmirësojmë Infrastrukturën dhe Teknologjinë:** Investimi në infrastrukturë moderne dhe teknologji të avancuara për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për mësim dhe studim.
4. **Zhvillojmë Strategji Efektive të Marketingut:** Përdorimi i strategjive të ndryshme të marketingut, për të tërhequr studentët nga segmente të ndryshme, duke përfshirë fushata online, pjesëmarrje në panairë arsimore dhe bashkëpunime me shkolla të mesme dhe universitete të tjera.

#### 4.6 Monitorimi i konkurrencës dhe mundësive në treg

Për të qëndruar konkurrues në tregun e arsimit të lartë, Kolegji Universitar “LOGOS” për çdo program studimi do të:

1. **Monitorojë Konkurrencën:** Do të vëzhgohen vazhdimisht konkurrentët për të kuptuar strategjitë e tyre dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim dhe inovacion.
2. **Zhvillojë Avantazhe Konkurruese:** Do të krijohen avantazhe konkurruese duke synuar cilësi të lartë të mësimdhënies dhe një mjedis mbështetës për studentët.
3. **Përmirësojë Reputacionin dhe Markën:** Investimi në ndërkombëtarizimin e Kolegjit për të rritur njohjen dhe atraktivitetin e tij në tregun e arsimit të lartë.

## 5. PLAN VEPRIMET

### 5.1 Plan veprimi për rritjen e ndërkombëtarizimit

#### 5.1.1 Objektivi: Rritja e kapaciteteve për ndërkombëtarizim

Plani i veprimit:

- Identifikimi dhe prioritizimi i institucioneve për bashkëpunim akademik. Zgjerimi dhe diversifikimi i partneriteteve strategjike të LOGOS me institucione në Ballkan dhe Europë.
- Anëtarësimi në rrjete të reja akademike dhe fuqizimi i rolit në ato ekzistuese.
- Promovimi i shkëmbimeve të studentëve, studiuesve dhe stafit akademik përmes programeve të mobilitetit.
- Harmonizimi dhe koordinimi i proceseve për ofrimin e programeve me diploma të dyfishta.
- Thjeshtimi i procedurave për aplikime në projekte si Erasmus+ .

- Organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta në fushën studimore dhe kërkimore.
- Forcimi i lidhjeve me Alumni dhe ish-stafin akademik që janë aktualisht të angazhuar në institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë.

### **5.1.2 Objektivi: Programe studimi të përbashkëta dhe mobilitete afatgjata, me fokus kryesor ciklin e dytë dhe të tretë.**

Plani i veprimit:

- Realizimi i studimeve të avancuara mbi kualifikimet profesionale në tregun ndërkombëtar, me një theks të veçantë te profesionet e së ardhmes.
- Promovimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në fusha akademike që lidhen me prioritetet e lartpërmendura.
- Vlerësimi dhe identifikimi i kapaciteteve të secilës njësi kryesore, për zbatimin e programeve të përbashkëta dhe kërkimit aplikativ.
- Përpunimi i detajuar i kuadrit ligjor dhe financiar, për të lehtësuar njohjen dhe transferimin e krediteve, si dhe mobilitetin e stafit dhe studentëve.
- Krijimi i programeve ndërkombëtare, trajnimeve dhe shkollave verore, të fokusuara në kualifikime afatshkurtra për staf akademik, studentë, alumni dhe palë të tjera të interesuara.

### **5.1.3 Objektivi: Kërkim i përbashkët shkencor sipas standardeve ndërkombëtare.**

Plani i veprimit:

- Promovimi i organizimit të aktiviteteve të përbashkëta shkencore me karakter ndërkombëtar dhe unifikimi i procedurave dhe dokumentacionit për to.
- Diskutimi dhe zbatimi i politikave stimuluese për të inkurajuar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në aktivitete kërkimore jashtë vendit.
- Përmirësimi dhe përditësimi i fondit të literaturës kërkimore, në dispozicion të stafit akademik.
- Përmirësimi i cilësisë së Buletinit Shkencor përmes zgjerimit të Bordit Shkencor, me ekspertë nga universitetet partnere, botimi në gjuhën angleze dhe aplikimi për indeksim ndërkombëtar.
- Inkurajimi i publikimeve shkencore në revista me indeksim të njohur ndërkombëtar.
- Angazhimi i studentëve në kërkim shkencor dhe krijimi i lidhjeve me partnerë ndërkombëtarë, për organizimin e aktiviteteve shkencore të përbashkëta.
- Integrimi i mësimdhënies online në kurrikulën universitare dhe zgjerimi i ofertës së programeve në formën e “blended learning” (mësimdhënie e ndërthurur).
- Përfshirja e moduleve mbi sipërmarrjen dhe inovacionin në kurrikulën universitare, si dhe

krijimi i hapësirave për zhvillimin e tyre

#### **5.1.4 Objektivi: Ndërkombëtarizimi përmes mësimdhënies**

Plan veprimi:

- Ofrimi i programeve studimore të dyfishta/joint.
- Krijimi i mundësive për të tërhequr studentë të huaj.
- Rritja e mobilitetit të stafit akademik për mësimdhënie në universitete të huaja.
- Rritja e mobilitetit të studentëve, për zhvillimin e një periudhe studimi në universitete të huaja.
- Shtimi i numrit të profesorëve vizitorë.
- Rritja e marrëveshjeve ndërinstitucionale me universitete evropiane.
- Nxitja e pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare.
- Inkurajimi i studentëve për të marrë pjesë në mobilitete, për zhvillimin e një pjese të studimeve të tyre.
- Riorganizimi i kurrikulave për t'iu përshtatur nevojave të tregut ndërkombëtar.
- Përmirësimi i aftësive mësimdhënëse të pedagogëve të Kolegjit Universitar LOGOS, përmes trajnimeve të ndryshme.
- Kërkesa për krijimin e hapësirave ligjore e rregullative lidhur me mundësinë e zhvillimit të leksioneve në formë hibride.
- Ofrimi i klasave studimore në gjuhë të huaja.

#### **5.1.5 Objektivi: Krijimi i bashkëpunimeve të qëndrueshme me partnerë të huaj**

Plan veprimi:

- Ndërtimi i një udhëzuesi specifik për implementimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.
- Ndërprenja e marrëdhënieve me institucionet që, pavarësisht marrëveshjeve, nuk kanë realizuar asnjë implementim.

#### **5.1.6 Objektivi: Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare**

Pjesëmarrja aktive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare do të sjellë përfitime të shumta për Kolegjin Universitar LOGOS, përfshirë:

1. **Rritja e Reputacionit dhe Njohjes:** Angazhimi në projekte të rëndësishme, do të rrisë reputacionin dhe njohjen e Kolegjit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. **Zhvillimi i Aftësive dhe Njohurive:** Studentët dhe stafi do të kenë mundësi të zhvillojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre ,përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe zhvillimore.
3. **Financimi dhe Burimet Shtesë:** Pjesëmarrja në projekte të financuara, do të sigurojë burime shtesë për zhvillimin e programeve akademike dhe kërkimore.

4. **Ndikimi Pozitiv në Komunitet:** Projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

## 5.2 Plan veprimi për bashkëpunimin me Partnerë

### Krijimi i Partneriteteve me Industrinë Lokale

Për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të siguruar që programet tona akademike janë në përputhje me nevojat e tregut të punës, Kolegji Universitar “LOGOS” do të fokusohet në krijimin e partneriteteve të forta me industrinë lokale. Kjo përfshin:

- **Bashkëpunimi me Kompani dhe Organizatave Relevante:** Do të vijohet me bashkëpunimet me kompani dhe organizata që operojnë në fusha të ndryshme dhe që kanë nevojë për profesionistë të kualifikuar.
- **Nënshkrimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me institucione të edukimit brenda dhe jashtë vendit:** Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit që përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë dhe që sigurojnë përfitime të ndërsjella.

Për të siguruar që bashkëpunimet me partnerët të jenë të frytshme dhe të qëndrueshme, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

### 5.2.1 Programet e Praktikës dhe Trajnimit:

- **Ofrimi i Praktikave Profesionale:** Krijimi i programeve të praktikës profesionale për studentët në bashkëpunim me kompanitë dhe organizatat lokale, duke u ofruar atyre mundësi për të fituar përvojë praktike dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale.
- **Trajnime të Përbashkëta:** Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për studentët dhe stafin akademik në bashkëpunim me industrinë, për të siguruar që ata janë të përgatitur për sfidat e tregut të punës.

### 5.2.2 Projekte të Përbashkëta Kërkimore:

Do të vijohet me:

- **Zhvillimin e Projekteve Kërkimore:** Bashkëpunimi me kompanitë dhe organizatat, për të zhvilluar projekte kërkimore që adresojnë sfidat reale të industrisë dhe që kontribuojnë në zhvillimin e njohurive dhe inovacionit.
- **Financimi i Projekteve Kërkimore:** Sigurimi i financimit të përbashkët për projekte kërkimore, që kanë potencial për të sjellë përfitime të ndërsjella dhe për të rritur konkurrencën e kolegjit dhe industrisë.



### 5.2.3 Evente dhe Workshop-e të Përbashkëta:

- **Organizimi i Eventeve:** Organizimi i eventeve të përbashkëta, si konferenca, seminare dhe workshop-e, që sjellin së bashku studentët, stafin akademik dhe profesionistët e industrisë për të ndarë njohuri dhe përvoja.
- **Pjesëmarrja në Panaire dhe Ekspozita:** Pjesëmarrja në panaire dhe ekspozita të industrisë, për të promovuar programet tona akademike dhe për të krijuar mundësi të reja bashkëpunimi.

### 5.2.4 Këshillat dhe Komitetet Këshillimore:

- **Krijimi i Këshillave Këshillimore:** Formimi i këshillave këshillimore, që përfshijnë përfaqësues nga industria dhe që ofrojnë këshilla dhe udhëzime për zhvillimin e programeve akademike dhe kërkimore.
- **Mbledhjet e Rregullta:** Organizimi i mbledhjeve të rregullta me këshillat këshillimore, për të diskutuar përparimet dhe për të identifikuar mundësi të reja bashkëpunimi.

## 5.3 Plan veprimi për rritjen e qëndrueshme dhe cilësore të regjistrimeve në Kolegjin Universitar “LOGOS”

Për të rritur regjistrimet dhe tërhequr studentë cilësorë do të ndjekim një strategji gjithëpërfshirëse që përfshin metoda moderne marketingu dhe një oferte akademike të diversifikuar duke siguruar gjithashtu mbështetje financiare dhe mundësi zhvillimi për studentët. Kjo strategji do të fokusohet në përdorimin e kanaleve të marketingut digjital, partneriteteve me shkollat e mesme, dhe krijimin e mundësive për një përvojë akademike të shkëlqyer dhe të personalizuar

**Marketingu Digjital:** Përdorimi i platformave të mediave sociale, si Facebook, Instagram, LinkedIn etj., për të ndarë histori të suksesshme të studentëve, mundësi akademike dhe ngjarje që zhvillohen në Kolegjin Universitar “LOGOS”. Reklamat online dhe fushatat Google Ads mund të targetojnë studentët që kërkojnë mundësi edukative brenda dhe jashtë vendit, si dhe mund të shfrytëzohen për të promovuar bursa dhe mundësi të tjera financiare. Përdorimi i SEO (Optimizimi i Motorëve të Kërkimit) do të mundësojë që faqja e internetit të Kolegjit Universitar “LOGOS” të dallohet më shumë në kërkimet online.

**Pjesëmarrja në Panaire Arsimore:** Pjesëmarrja në panaire arsimore dhe evente të ngjashme, për të promovuar programet tona dhe për të ndërvepruar drejtpërdrejt me studentët potencialë.

**Bashkëpunimi me Shkollat e Mesme:** Krijimi i partneriteteve me shkollat e mesme, jo vetëm për prezantime, por gjithashtu për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta edukative, si leksione të

hapura, trajnime, workshop-e, seminare apo konkurse. Bashkëpunimi mund të përfshijë gjithashtu mundësi për mentorim nga studentët aktualë të Kolegjit Universitar “LOGOS” duke ndihmuar studentët potencialë të njihen me realitetin e jetës akademike dhe mundësitë që ofrohen.

**Zgjerimi i Ofertës Akademike: Programe të Reja Studimi:** Zhvillimi i programeve të reja studimi, që janë në përputhje me kërkesat e tregut dhe interesat e studentëve potencialë; **Programe të Specializuara:** Ofrimi i programeve të specializuara dhe të personalizuar, që adresojnë nevojat specifike të segmenteve të ndryshme të studentëve.

### 5.3.1 Fushata Marketingu dhe Promovimi:

| Veprimtari                       | Qëllimi                                                                                                                                      | Instrumenta të matshëm                                                                                           |
|----------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Marketingu Digjital              | Për të arritur një audiencë të gjerë dhe tërhequr studentë të rinj.                                                                          | Përdorimi i platformave si Facebook, Instagram, Google Ads, SEO për rritjen e dukshmërisë në motorët e kërkimit. |
| Pjesëmarrja në Panairë           | Të ndërveprojmë drejtpërdrejt me studentët potencialë dhe të promovojmë programet e Kolegjit “LOGOS”.                                        | Prezantime, broshura, video, fletushka dhe biseda me studentët potencialë.                                       |
| Bashkëpunimi me Shkollat e Mesme | Krijimi i mundësive për prezantime dhe aktivitete edukative.                                                                                 | Organizimi i workshop-eve, seminareve, mundësive mentorimi dhe aktiviteteve edukative me shkolla të mesme.       |
| Marketingu me Histori Studentore | Të inspirojmë studentët potencialë përmes histori suksesi dhe përvojave pozitive të studentëve dhe alumnëve të Kolegjit Universitar “LOGOS”. | Video dhe postime në mediat sociale për studentët që ndajnë përvojat e tyre.                                     |

### 5.3.2 Zgjerimi i Ofertës Akademike:

| Veprimtari                                      | Qëllimi                                                                                                                 | Instrumenta të matshëm                                                                       |
|-------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|
| Programe të Reja Studimi                        | Ofrimi i programeve të reja që janë të përputhshme me kërkesat e tregut dhe interesat e studentëve.                     | Analizë tregu për kërkesat e fushave të reja të studimit dhe zhvillimi i programeve të reja. |
| Programe të Specializuara dhe të Personalizuara | Ofrimi i programeve që adresojnë nevojat e studentëve në sektorë të ndryshëm si teknologji, biznes dhe shkenca sociale. | Krijimi i moduleve të personalizuar, programe shkollash verore, dhe mundësi të lëvizshme.    |

### 5.3.3 Bursa dhe Ndihma Financiare:

| Veprimtari                     | Qëllimi                                                                                                                            | Instrumenta të matshëm                                                                           |
|--------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Rritja e Numrit të Bursave     | Rritja e mundësive për studentët që kanë rezultate të larta dhe ata me nevoja financiare për të bërë studimet më të përballueshme. | Ofrimi i bursave për studentët që kanë performancë të shkëlqyer dhe që kanë nevoja financiare.   |
| Programet e Ndihmës Financiare | Ofrohen mundësi për mbështetje financiare për studentët që kanë vështirësi të paguajnë tarifat e studimeve.                        | Mundësi financimi, orientimi drejt bankave te nivelit të dytë për marrjen e kredive për studime. |

### 5.3.4. Metodat e Reja për Promovimin e Kolegjit Universitar “LOGOS” dhe Tërheqjen e Aplikantëve Cilësorë:

| Veprimtari                                                       | Qëllimi                                                                                                                                     | Instrumenta të matshëm                                                                                           |
|------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Përmirësimi i Prezencës Online</b>                            | Sigurimi që website-i dhe platformat sociale të Kolegjit janë të përditësuara dhe lehtësisht të navigueshme për aplikantët.                 | Përditësimi i faqes, optimizimi i përdorimit të platformave të mediave sociale për komunikim dhe informim.       |
| <b>Marketing Digjital përmes Përmbajtjes (Blog, Video, etj.)</b> | Krijimi i përmbajtjeve të vlefshme për studentët potencialë dhe ndarjen e përvojave pozitive të studentëve dhe stafit.                      | Blog, artikuj edukativë, video prezantuese dhe webinar-e për të ofruar informacione mbi programet dhe mundësitë. |
| <b>Angazhimi i Alumni-t dhe Rrjeti i Alumni-ve</b>               | Angazhimi i alumnëve për të promovuar Kolegjin Universitar “LOGOS” dhe për të dhënë informacione rreth mundësive të karrierës dhe suksesit. | Organizimi i aktiviteteve dhe eventeve të Alumni-t për ndihmën e aplikantëve të rinj dhe për promovimin e LOGOS. |
| <b>Evente të Alumni-ve dhe Takime Informative</b>                | Ndihma në krijimin e një komuniteti të fortë dhe inkurajimi i rekomandimeve dhe mundësive të networking-ut për studentët e rinj.            | Evente fizike dhe online për alumni dhe takime informative për studentët e rinj.                                 |

### 5.3.5 Shërbime dhe Mbështetje për studentët në kuadër të Ndërkombëtarizimit:

| Veprimtari                                              | Qëllimi                                                                                                                    | Instrumenta të matshëm                                                                                                |
|---------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Krijimi i Udhëzuesve për Studentët Ndërkombëtarë</b> | Të ofrohet mbështetje për studentët ndërkombëtarë që janë të interesuar për të studiuar në Kolegjin Universitar “LOGOS”.   | Udhëzues për studentët ndërkombëtarë për përgatitjen e vizave, akomodimin dhe përshtatjen me jetën universitare.      |
| <b>Programi i Mikpritjes për Studentët e Huaj</b>       | Të krijohen mundësi për të ndihmuar studentët ndërkombëtarë që të përshtaten lehtësisht në mjedisin akademik dhe shoqëror. | Organizimi i aktiviteteve të integritimit dhe mentorimi për studentët ndërkombëtarë nga studentët aktualë dhe alumni. |

### 5.3.6. Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Ambientit të Studimeve:

| Veprimtari                                                 | Qëllimi                                                                                                                      | Instrumenta të matshëm                                                                                                     |
|------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Përmirësimi i Infrastrukturës</b>                       | Sigurimi i një ambienti të përshtatshëm dhe bashkëkohor për studentët, duke mundësuar përdorimin e teknologjisë së avancuar. | Investimi në laboratorë moderne, mundësi për mësim online dhe përdorimin e platformave digjitale për studim dhe komunikim. |
| <b>Përmirësimi i Hapësirave të Studimeve dhe Pushimeve</b> | Krijimi i një ambienti tërheqës dhe të rehatshëm për studentët për studim, aktivitete dhe relaksim.                          | Renovimi i ambienteve të studimit, krijimi i hapësirave për grupet e studimit dhe mundësi për aktivitete jashtëmësimore.   |

### 5.3.7. Lidhja me Biznesin dhe Mundësitë e Karrierës:

| Veprimtari | Qëllimi | Instrumenta të matshëm |
|------------|---------|------------------------|
|------------|---------|------------------------|

|                                                 |                                                                                                     |                                                                                                                            |
|-------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Partneritete me Biznese dhe Institucione</b> | Zgjerimi i mundësive të punësimit dhe internships për studentët gjatë studimeve dhe pas diplomimit. | Zgjerimi i partneriteteve me kompani të ndryshme për mundësi internships dhe punësimi për studentët.                       |
| <b>Krijimi i Eventeve për Karrierën</b>         | Të organizohen aktivitete që mundësojnë lidhjen e studentëve me mundësi punësimi.                   | Organizimi i panairove të punës, takimeve me ekspertë të industrisë dhe trajnimeve për zhvillimin e aftësive profesionale. |

### 5.3.8. Angazhimi dhe Aktivitetet Studentore:

| <b>Veprimtari</b>                                        | <b>Qëllimi</b>                                                                                              | <b>Instrumenta të matshëm</b>                                                                                           |
|----------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Organizimi i Aktiviteteve të Jashtëmësimore</b>       | Të ofrohen mundësi për zhvillim të aftësive jo-akademike dhe të krijohen mundësi socializimi për studentët. | Aktivitetet kulturore, sportive, klube studentore dhe aktivitete jashtëmësimore që kontribuojnë në zhvillimin personal. |
| <b>Angazhimi i studentëve në projektet ndërkombëtare</b> | Për të përfshirë sa me shume student në projekte                                                            | Takime me studentët dhe dhënien e punëve konkrete në projekte.                                                          |

### 5.3.9. Marrëdhëniet me Komunitetin dhe Institucionet e Tjera Arsimore:

| <b>Veprimtari</b>                                                       | <b>Qëllimi</b>                                                                                                           | <b>Instrumenta të matshëm</b>                                                                                                    |
|-------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Zhvillimi i Marrëdhënieve me Institucione Arsimore Ndërkombëtare</b> | Të forcohen marrëdhëniet me universitete dhe institucione të tjera ndërkombëtare për mundësi shkëmbimi dhe bashkëpunimi. | Krijimi i marrëveshjeve për shkëmbime studentore dhe mundësi studimi në huaj.                                                    |
| <b>Inkurajimi i Programet e Lëvizshmërisë dhe Shkëmbimit</b>            | Të ofrohen mundësi për studentët që të zhvillojnë përvoja ndërkombëtare dhe të rrisin profilin ndërkombëtar të Kolegjit. | Ofrimi i mundësive për shkëmbim akademik dhe internships ndërkombëtare, si dhe krijimi i marrëveshjeve me universitete të huaja. |